

Siguri

Ekskluzive | Të shtëna me armë në aheng familjar në Podujevë – Policia sekuestron tri armë, tre persona pranojnë veprën



Sinjali.com

30 Korrik 2026 08:56



Një aheng familjar në fshatin Kërpimeh të Podujevës ka përfunduar me ndërhyrjen e Policisë së Kosovës, pasi u raportuan të shtëna me armë gjatë mbrëmjes.

Sinjali mëson se personat e dyshuar janë **Bajram Kastrati (66-vjeç)**, **Halil Zogjani (74-vjeç)** dhe **Edison Hajrizi (22-vjeç)**.

Sipas burimeve, rasti është raportuar rreth orës 21:00, ndërsa njësitë policore kanë dalë menjëherë në vendin e ngjarjes. Gjatë patrullimit, policët kanë dëgjuar vetë të shtëna me armë, çka ka çuar në ndërhyrjen e menjëhershme.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit është kryer kontroll në lokacion, ku janë sekuestruar tri armë:

- një revolver me gjashtë fishekë;
- një pistoletë “SIG Sauer”;
- një armë me gaz e tipit “Blow”.

Tre të dyshuarit janë shoqëruar në Stacionin Policor dhe janë intervistuar në prani të avokatëve mbrojtës. Sipas burimeve, ata e kanë pranuar në tërësi veprën, duke deklaruar se armët i kishin përdorur gjatë një ahengu familjar.

Me urdhër të Prokurorit është iniciuar rasti për veprat penale “Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, ndërsa Bajram Kastrati, Halil Zogjani dhe Edison Hajrizi janë liruar në procedurë të rregullt.

Rasti mbetet nën hetime.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera